

TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 2008

TLAS NE 13 GJYKATA

CAFOD
just one world

FALENDEROJMË CAFOD UK PËR MBËSHTETJEN
FINANCIARE TË KËTJË BOTIMI

SHERBIM LIGJOR FALAS NE GERDEC

Zyra e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS, ndikon drejtëpërdrejt në mbr ojtjen e të drejtave themelore të individëve në nevojë¹, në përmirësimin e sistemit demokratik të qeverisjes, në përcaktimin e përgjegjësisë individuale dhe shtetërore, si dhe në zhvillimin normal të shoqërisë. Aktualisht ndihma ligjore për çështjet civile në Shqipëri është kontribut vetëm i disa OJF've gjë që do të thotë se numri i individëve që e përfitojnë atë është i kufizuar. Por në kushtet e tragjedisë së Gërdecit, të datës 15 Mars 2008, në kushtet kur numri i viktimave vjen duke u rritur dhe pasojat po prekin një numër të konsiderueshëm familjesh dhe qytetarësh, është detyrim kushtetues kthimi i vëmëndjes nga shtetasit që kanë pësuar dëme me pasojë humbjen e

¹ Individë në nevojë janë ata që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të patur një avokat që do të përfaqësojë atë për të përfituar të drejtat që i takojnë.

jetës, të pasurisë, të shëndetit, të shkatërrimit të ambjentit, etj.

Stafi i TLAS si shumë organizata të tjera nuk mund të mos përfshihej në lehtësimin e situatës social-ekonomike:

së pari të familjeve të viktimave dhe **se dyti** të të dëmtuareve të tjerë të fshatit Gerdec dhe ato përreth tij.

Këto do të arrihen përmes ofrimit të një larmie shërbimesh ligjore falas si këshillime ligjore, përfaqësimeve në gjykatë dhe në administratë, trajtime të rasteve me "clinics" dhe "hotline", etj.

Kujtojmë atë ditë të zezë për kombin Shqiptar, 15 Marsin 2008



kur një fabrikë për c'aktivizimin e municijoneve, e vendosur në një afërsi jashtë normave ligjore të lejuara për zonat e banuara, u përfshi nga një shpërthim shumë i fuqishëm i municjonit të grumbulluar në të, duke shkaktuar vdekjen e 26 jetëve njerëzore, mbi 300 persona të plagosur, nga të cilët një pjesë të dëmtuar shumë rëndë, 4200 banesa të dëmtuara nga të cilat 412 janë të shkatërruara plotësisht, e shumë dëme të tjera të pallogaritura në sistemin psikologjik të banorëve, kryesisht të fëmijëve që më shumë kohë do të flenë dhe do të zgjohen të tmerruar nga kjo ndodhi.

Me keqardhje kujtojmë se nuk është hera e parë që një situatë



e tillë tragjike ndodh në vendin tonë. Tragjedi të ngjashme kanë ndodhur jo shumë kohë më parë në Farkë, në Karaburun, në minierën e Bulqizës e gjetkë. Janë po ashtu të shpeshta rastet kur kompani të ndryshme duke mos respektuar rregullat e sigurimit teknik kanë shkaktuar dëmtime të rënda të jetës së punonjësve të tyre. Nga ana tjetër punësimi i paligjshëm e i papërshtatshëm i grave dhe i fëmijëve është një tjetër fakt i hasur shpesh edhe pse flitet aq shumë për mosshfrytëzimin e punës së tyre, edhe pse shpesh deklarohet e kundërta, ky fenomen vazhdon të ketë përmasa të mëdha, të padeklaruara dhe të konsiderueshme.

Deri me sot fatkeqësisht nuk janë ndjekur raste kolektive ligjore për dëmin e shkaktuar dhe nuk janë bërë publike përgjegjësitë qoftë ato të Shtetit për shtetasit e vet, apo të firmave dhe personave juridike që shkaktojnë tragjedi njerëzore të përmasave të tilla. Nuk mund të flasim për sigurim të aksesit në drejtësi për

gjithë qytetarët nëse individët në nevojë vazhdojnë të jenë të përjashtuar nga të drejtat themelore.

Le të kujtojmë Kushtetutën e Shqipërisë për garantimin e të drejtave bazë si:

NENI 18: Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

NENI 42: Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e panshme e caktuar me ligj.

Në këto rrethana për t'i ardhur në ndihmë viktimave të tragjedisë së fshatit Gërdec por edhe për të promovuar një model i cili do të dekurajojë sjellje të papërgjegjshme të cilat sjellin pasoja tragjike për jetën, TLAS u angazhua dhe paraqiti në bordin e SOROSIT një projekt propozim me disa objektiva specifike që kanë për qëllim :

- Përcaktimin e përgjegjësisë së Shtetit për dëmin e shkaktuar

shtetasve të tij

- Rritjen e nivelit të përgjegjësisë civile e qytetare të shtetasve në raport me punëdhënësin Shtet, me Shtetin dhe Privatin.

Si edhe disa Objektiva specifike:

1) Dëmshpërblimi i familjareve të (25) viktimave që humbën jetën në tragjedinë e Gërdecit.

2) Dëmshpërblimi i te demtuarve të tjerë prej tragjedise së Gërdecit.

3) Evidentimi i mangësive në legjislacionin aktual për shfrytëzimin në punë të grave dhe fëmijëve, për sigurimin e jetes dhe rekomandime për përmirësimin e tij.





Disa nga Aktivitetet qe do të ndërmarre TLAS me qëllim që të arrihen rezultatet e menduara janë:

- Hapja e zyrës ne Gërdec ku avokatët e qëndrave do të punojnë cdo ditë sa më afër të dëmtuarve
- Ofrimi i Shërbimit të plote ligjor (keshillim dhe perfaqesim ne gjykate) për familjarët e 25 viktimave të Gërdecit me objekt "përcaktimin e përgjegjë-sive civile për dëmin e shkaktuar jetës, shëndetit, dëmin pasuror dhe dëmin moral"
- Përgatitja e gjyqit kolektiv i cili në këtë rast ka shumë përbërës apo nëncështje duke filluar me:
- Përfaqësimin në gjykatë për

celje trashëgimie për cdo familje

- Përfaqësim në gjykatë për kërkim shpërblimi për dëmin e jetës dhe përcaktimin e personeve përgjegjës për shkaktimin e dëmit. (gjyq kolektiv i cili mund të ndahet nga gjykata në disa gjyqe të vecanta)

- Procesi per trajtimin e kesaj ceshtjeje kerkon sigurimin e dokumentave mbeshtetese si: kontratat dhe dokumentat shkresore qe kane lidhje me ligjshmerine e aktivitetit ne Gerdec;

- Burimet e transportit te municioneve ne Gerdec;

- Kontratat qe jane lidhur per percaktimin e kohes dhe rregulloren e punes;

- Kontratat e punes se punonjesve (sigurimet shoqerore dhe shendetesore, tatimet e punonjesve);

- Akte te qeverise dhe Ministrise se Mbrojtjes ne lidhje me kete aktivitet;

- Ligji i fundit i 2007 për tregëtinë e armatimit dhe municioneve;

- Grumbullimi i të dhënave të mediave për ngjarjen; Përcaktimi i vlerave të dëmit ekonomik

përmes ekspertizës së 3-4 personave të fushave të ndryshme si të ndihmës social- ekonomike, të mjekësisë, ambjentit, etj;

- Baza ligjore për Roli i shtetit në monopolin për tregëtinë e armëve;

- Rishikimi i legjislacionit analog të vendeve të rajonit;

- Raste të gjykatës së Strasburgut për dëme shkaktuar shëndetit dhe përgjegjësia e shtetit për dëmshpërblimin e tij", e shumë aktivitete të tjera si:

- Organizim i vizitave dhe takimeve përmes "Street law " në familjet e Gerdecit, shpërndarja e fletëpalosjeve të botuara me këtë qëllim, i posterave gjithashtu.²

- Organizim i shërbimeve ligjore " mobile" në fshatin e Gerdecit

-Shërbim këshillimor në zyrat e TLAS dhe CLCI për të paktën 40 grup rastesh të tjera të komp

likuara që janë dëmtuar prej tragjedisë së Gerdecit dhe që do të aftësohen të ndjekin edhe vet problemet e tyre ligjore .

Rajmonda BOZO
Drejtore Ekzekutive e TLAS



² Në vazhdim shikoni dy botimet që TLAS realizoi për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve e familjarëve të dëmtuar.

KOMENTE MBI KENAQESINE E PUBLIKUT PER SHERBIMET E OFRU- ARA NGA GJYKATAT

Gjatë muajit maj 2008, në vazhdim të aktivitetëve të saj për të ndihmuar sa më gjërësisht grupet e popullsisë në nevojë, TLAS organizoi pyetjen e publikut në gjykatat e rretheve gjyqësore Durrës, Vlorë, Korçë, Shkodër, Elbasan, Pogradec, Sarandë, Gjirokastrë, Mat, gjykata e shkallës së parë për krimet e rënda si dhe gjykatat e Apelit Tiranë dhe Gjirokastrë me qëllim "matjen e kënaqësisë së opinionit publik për shër-

bimet e ofruara nga gjykata". Ky program u iniciua si rrjedhojë e konceptit të TLAS mbi gjykatat si një shërbim shtetëror për shoqërinë. Nisur nga ky koncept prej kohësh ndjehej e nevojshme vlerësimi i cilësisë së shërbimeve gjyqësore me synimin e evidentimit të problemeve zgjidhja e të cilave do të përmirësonte këtë shërbim. I vetëdijshëm për rëndësinë e këtij shërbimi për grupet e shoqërisë, të cilët për shkak të gjëndjes ekonomike nuk mund të realizojnë vetë shërbimet e avokatisë, TLAS në vazhdimësi ka synuar të ndikojë në përmirësimin e këtyre shërbimeve.

Organizimi i aktivitetëve profesionale, të cilat ndikojnë në realizimin më të mirë të të drejtave të ligjshme të individëve në nevojë ka qenë gjithnjë ndër prioritetet e TLAS. Kjo strategji lidhet me shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore të angazhuara në shërbim të nevojave ligjore të njerëzve të cilët, për shkak të gjëndjes ekonomike nuk mund ta sigurojnë



këtë shërbim kundrejt pagesës. Metodologjia e matjes së kënaqësisë së publikut nga shërbimet e gjykatës bazohej para së gjithash në vjeljen e një opinioni sa më objektiv të të intervistuarve. Caktimi i grupeve të të intervistuarve u bë mbi baza shkencore nga specilaistë të fushës së statistikave. Për të shmangur ndikimin në opinione u realizuan intervista ditore me publik që është i lidhur drejtëpërdrejt me shërbimet gjyqësore. Para së gjithash u synua të tërhiqej opinioni i personave të cilët sapo kishin patur një eksperiencë të drejtëpërdrejtë individuale me një shërbim gjyqësor. Krahas tyre u tërhoq edhe opinioni i personave që janë në kontakt të përhershëm me shërbimet e gjykatës si, vetë personeli administrativ i gjykatave, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ekspertë etj. Ndonëse marja e opinioneve bazohej mbi anonimatën e të intervistuarve, për efekte të vlerësimit të opinioneve përcaktohej në pyetsor edhe kategoria e personave të intervistuar. Për kon-



kluzionet e matjes është përpiluar edhe një raport përmbledhës, por në këtë artikull dëshiroj të evidentoj disa opinione mbi rezultatet e këtij aktiviteti.

Komente në tabelën e parë (pyetja e qytetarëve)

Treguesi themelor i kënaqësisë ndaj shërbimeve të gjykatave është 53.9%. Në kushtet e mungesës së matjeve të tjera krahasuese është e vështirë të vlerësosh këtë tregues si pozitiv ose jo. Megjithatë ky tregues do të shërbejë si një matës i parë për të bërë krahasime me aktivitete të ngjashme që mund të realizohen në të ardhmen. Treguesit më të ulët përsa i për-

ket kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e gjykatave, janë ato të lidhura me Pyetja 7 (46.5%) dhe Pyetja 8 (40.2%).

Këto tregues të ulët lidhen me mënyrën se si gjykatat ruajnë të dhënat e gjykimeve (regjistrimi i seancave gjyqësore me anë të procesverbalit) pasi ende përdoret mënyra e shkrimit me dorë, duke krijuar një imazh të dobët qartësie, saktësie dhe sigurie për përdoruesit publik të gjykatës. Për më tepër, vendimet e shkruara të gjykatës nuk jepen në afatin e duhur dhe kanë një mungesë të cilësive themelore (ato nuk janë shumë të kuptueshme). Këto gabime në vendimet e shkruara të gjykatës, së pari përbëjnë vështirësi për qytetarët për të ushtruar të drejtën e tyre të ankimit, dhe së dyti, ndikojnë negativisht cënimin e autoritetit publik të gjykatave pasi një vendim i paarrësytuar qartë dëmton imazhin e drejtësisë para qytetarëve.

Komente në tabelën e dytë (gjyqtarë)

Në pyetjen 10 treguesi ka një mesatare prej 58.6% (dy gjykata janë përjashtuar pasi gjyqtarët, që punojnë aty nuk kanë dhënë asnjë opinion). Kjo mesatare tregon se vetë gjyqtarët nuk janë të kënaqur nga shërbimi i gjykatave ku ata punojnë. Kjo shpreh opinionet e gjyqtarëve për faktin se ka një nevojë për të ndërhyrë në elementët që influencojnë në përmirësimin e shërbimeve të gjykatës.

Komente në tabelën e tretë (të punësuarit-administrate gjyqësore)

Krahasuar me treguesit e Pyetjes 10 për kënaqësinë e të





punonjësve të administratës gjyqësore (56.38%) me ato të gjyqtarëve (58.6%), është e qartë se kënaqësia e punonjësve të administratës gjyqësore është më e ulët. Meqë administrata gjyqësore është elementi më i rëndësishëm në dhënien e shërbimit në gjykatë, kjo na tregon se kënaqësia e ulët e nëpunësve të gjykatës është e lidhur me kushtet e punës së tyre, dhe kjo tregon qartë se ndikon gjithashtu në kualitetin e shërbimit të tyre.

Komente në tabelën katër (prokurorët)

Kënaqësia e prokurorëve rreth shërbimit të gjykatës është më e lartë krahasuar me përdoruesit e tjerë të gjykatës (69.4%). Kjo

përqindje është e mundshme vetëm për prokurorët publik që kanë shprehur opinionet e tyre. Kjo e dhënë mund të shpjegohet si diskriminim pozitiv i prokurorëve, e bërë nga nëpunësit e gjykatës, në lidhje me përdoruesit privat të shërbimeve gjyqësore. Një tjetër shpjegim i mundshëm është se këta prokuror publik kanë informacion më të mirë për shërbimin që gjykata siguron, dhe në këtë mënyrë ata nuk kanë shumë probleme për të marrë shërbimin që kanë nevojë. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë kënaqësinë e avokatëve (ata kanë 49.5%), është më e thjeshtë për të nxjerrë si përfundim, se ndryshimet në përqindjen e kënaqësive, janë për shkak të shërbimit diskriminues ndaj përdoruesve të gjykatës.

Komente në tabelën pesë (avokatët)

Në qoftë se krahasojmë treguesit e Pyetjes 5 për sa i përket kënaqësisë së qytetarëve me atë të avokatëve, ne vërejmë se opinionet e gjyqtarëve janë

se, avokatët trajtohen më me shumë respekt (64.1%) në krahasim me qytetarët (52.1%). Nga ana tjetër, është shumë e qartë se kënaqësia e avokatëve rreth shërbimit të gjykatës është e ulët (49.5%). Ky tregues i fundit për shërbimin e gjykatave nuk është i pëlqyeshëm sidomos nëse mbajmë parasysh që ky opinion shprehet nga ato kategori subjektsh, të cilët janë vazhdimisht në kontakt me shërbimin e gjykatave. Kështu që, fakti që avokatët ndihen të trajtuar me respekt nga gjyqtarët, por ata nuk e vlerësojnë si efektiv shërbimin që ofrohet në gjykatë, është ende një

trgues i pakënaqsive të tyre për cilësinë e shërbimit të gjykatave.

Komente të përgjithshme.

Bazuar në rrethanat, ne nuk mund të injorojmë shqetësimin e të intervistuarve që, në rast të “vizitorëve të huaj”, gjyqtarët dhe punonjësit e tjerë të gjykatës i japin më shumë vëmendje sjelljes së tyre më qëllim që sjellja e tyre të shfaqet e përshtatshme kundrejt përdoruesve të gjykatës.

Vangjel KOSTA
Avokat TLAS



KONVENTA KUADËR PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE

Hyrje

Mbrojtja e minoriteteve është një çështje mjaft e rëndësishme për çdo shtet. Rëndësia e kësaj çështjei në zhvillimin dhe krijimin e detyrimeve ligjore për të garantuar standartet evropiane në mbrojtjen e minoriteteve. Ku shëmbull konkret dhe i dukshëm është Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve.

Kjo Konventë, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt 1998 – është instrumenti i parë ligjor kushtuar mbrojtjes së minoriteteve kombëtare dhe është pjesë përbërëse e mbrojtjes të drejtave të njeriut. Rëndësia e Konventës është e njohur botërisht. Ajo është e ratifikuar nga 39 shtete dhe e firmosur po ende e pa ratifikuar nga 4 shtete të tjera.

Konventa Kuadër, është njëra prej traktateve me të

plota, hartuar për të mbrojtur të drejtat e personave që i takojnë minoriteteve kombëtare. Palët në këtë konvente marrin angazhimin të sigurojnë barazimin e plotë dhe efikasë të personave të cilët i takojnë grupeve minoritare, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, si dhe kushtet që do t'ju lejojnë atyre të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre. Edhe Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në shtator 1999 dhe ka hyrë në fuqi në janar të 2000.

Pse quhet Konvente «Kuadër»?

Fjala «Kuadër» nënkupton





mundësinë që Shtetet të përkthejnë dispozitat e kësaj konvente duke u bazuar në situatën specifike të vendit të tyre, si dhe në legjislacionin dhe politikat e përshtatshme qeveritare, megjithatë kjo nuk i heq konventës aspak karakterin e detyrimit ligjor.

Ç'është një minoritet kombëtar?

Konventa Kuadër nuk e përmban një definicionin për konceptin «minoritet kombëtar», pasi nuk ekziston një përcaktim i përgjithshëm, i pranuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës. Megjithatë çdo palë në Kon-

ventën Kuadër i është lënë hapësirë për të vlerësuar se cilat grupe mund të përfshihen nga Konventa brenda territorit të tyre. Ky seleksionim duhet të bëhet me qëllim të mirë, dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe parimet themelore të përcaktuara në nenin 3 të Konventës Kuadër. Konventa Kuadër nuk është një instrument gjithçka ose asgjë. Për këtë arsye ky komitet këshilldhënës ka adoptuar një tekst të detajuar, nen për nen në lidhje me grupet që mbulohen nga Konventa Kuadër, duke pranuar se disa nene të Konventës kanë një hapësirë më të gjerë për të përfshirë një numër më të madh të grupeve sesa nenet e tjera. Për shembull, Neni 6 mbi tolerancën dhe dialogun ndërkulturor përfshin në hapësirën e vet një gamë më të gjerë grupesh sesa Neni 10 (2), i cili merret me përdorimin e gjuhës në raport me autoritetet publike. Disa persona megjithatë mund të përfitojnë nga disa nene, por jo domosdoshmërisht të gjithë.

Çfarë angazhimesh duhet të marrin Shtetet Palë pasi t'a kenë ratifikuar Konventën?

Dispozitat e Konventës Kuadër mbulojnë një numër të gjerë çështjesh, që përfshijnë:

- Mosdiskriminimi;
- Promovimin e kushteve që favorizojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, fesë, gjuhës dhe traditave;
- Lirinë e tubimit, bashkimit, shprehjes së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;
- Aksesin në dhe përdorimin e mediave;
- Lirinë e përdorimit të gjuhës :
- Përdorimin e gjuhës minoritare privatisht dhe publikisht, si dhe përdorimin e saj para autoriteteve administrative;
- Përdorimin e emrit të vet në gjuhën minoritare;
- Dhënies së informacioneve të natyrës private në gjuhën minoritare;
- Emrat topografik në gjuhën minoritare;

- Arsimin
- Mësimin dhe dhënien e instruksioneve në gjuhën minoritare;
- Lirinë e krijimit të institucioneve arsimore;
- Kontaktet ndërkufitare;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar;
- Pjesëmarrja në jetën ekonomike kulturore dhe sociale;
- Pjesëmarrja në jetën publike;
- Ndalimi i asimilimit të detyrueshëm.

Kush vendos nëse dikush bën pjesë në një grup minoritar?

Individët janë të lirë të vendosin



nëse dëshirojnë apo jo të bëjnë pjesë në një minoritet kombëtar.

Kjo nuk nënkupton se çdo person mund të vendosë në mënyrë arbitrare nëse i takon ndonjë minoriteti kombëtar. Zgjedhja e individit duhet të bazohet në kritere objektive që lidhen me identitetin e personit, siç janë gjuha, feja dhe kultura.

Kush është përgjegjës për monitorimin e Konventës?

Organet përgjegjëse për monitorimin e Konventës janë: Komiteti i Ministrave dhe Komiteti Këshilldhënës të përbërë nga ekspertë të pavarur.



Si merret informata mbi monitorimin ?

Duke u bazuar në sistemin raportues, procedura e monitorimit kërkon që çdo shtet të dorëzojë raportin e parë brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Konventes dhe raportet plotësuese çdo pesë vjet, ose në bazë të një kërkesë specifike të Komitetit të Ministrave. Komiteti Këshilldhënës dërgon pyetësore të shkruar aty ku kërkohen informacione të veçanta plotësuese.

Përpilimi i raporteve Shtetërore shpesh përfshin edhe procesin e konsultimit me organizatat minoritare dhe joqeveritare, të cilat inkurajohen ndërkohë që të dërgojnë raporte apo informacione alternative.

Këto raporte shqyrtohen nga Komiteti Këshilldhënës, i cili mund të përdorë burime të shumta të shkruara informative nga organizma shtetërore apo jo shtetërore. Komiteti Këshilldhënës ka ndërmarrë gjithashtu praktikën e kryerjes së vizitave në vende të ndryshme, ku takohet me zyrtarë qeveritare, parlamentarë, përfaqësues të

minoriteteve, OJQ-ve e Organeve të Specializuara si dhe me autorite të tjera relevante.

Çfarë ndodh pasi Komiteti Këshilldhënës përfundon vlerësimin?

Pas analizimit të raportit të një shteti të caktuar, Komiteti Këshilldhënës i transmeton atij shteti mendimin e tij, i cili ka mundësi që të japë komentet e tij në lidhje me këtë mendim. Është e hapur për shtetet që të bëjnë publike mendimin e Komitetit Këshilldhënës, dhe kjo mundësi është shfrytëzuar për një numër shtetesh. Në përgatitjen e përgjigjes së tyre, Palët Shtetërore mund të vendosin të përfitojnë nga konsultimet e mëtejshme me organizata minoritare dhe joqeveritare.

Pas kësaj është Komiteti i Ministrave që adapton një resolute me konkluzione dhe rekomandime për shtetin përkatës në lidhje me zbatimin e Konventës Kuadër. Kjo rezolutë bëhet publike sëbashku me komentet nga shteti palë, me mendi-

min e Komitetit Këshilldhënës, nëse kjo nuk është bërë publike në një fazë të mëparshme.

Çfarë veprimesh të tjera pa-suese ndërmerren?

Qeveritë janë të ftuara të informojnë rregullisht Komitetin Këshilldhënës për masat që kanë ndërmarrë, në lidhje me procesin monitorues. Një numër i madh të interesuarish inkurajohen të organizojnë vazhdimisht aktivitete, në mënyrë që të promovojnë një zbatim efikas.

Naureda Llagami
Avokate
TLAS



PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TË FAMILJEVE QË MARRIN STATUSIN “E PASTREHË”

Gjatë muajit maj dhe qershor 2008, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) u angazhua për të ndihmuar 20 familje, banorë të rrugës Gani Domi, pranë Bregut të Lanës, për të përgatitur dokumentacionin që duhet të dorëzohej në Bashkinë e Tiranës, në mënyrë që këto familje të përfitonin Bonusin e Qirasë, që kjo bashki jep për familjet që kanë marrë statusin “e pastrehë”. Për të fituar këtë status,

dokumentacioni i familjes shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës, që është instanca vendimmarrëse. (Për familjet që gëzojnë statusin e të pastrehit, bashkia e Tiranës paguan një pjesë të qirasë së banesës, masa e të cilës varret nga të ardhurat e familjes). Problemi i strehimit për këto familje lindi kur shtëpitë në të cilat ata banonin prej disa dekadash u prishën, për arsye se atje do të ndërtohet një rrugë e re.

TLAS u tregua shumë e gatshme të ndihmonte këto familje me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shkak se numri i dokumentave që duhet të dorëzoheshin nga secila familje ishte mjaft i madh, ndërkohë që koha ishte shumë e shkurtër.

Fillimisht u organizua një takim me të gjitha familjet, ku u prezantua puna e TLAS dhe u dhanë sqarime për dokumentacionin që duhej grumbulluar dhe për bashkëpunimin për realizimin sa më shpejt dhe sa më mirë të kësaj detyre. Në takimin



e parë u morrën edhe të dhënat për secilën prej familjeve dhe u lanë detyrat specifike që duhet të kryheshin nga vetë banorët. Takimi i parë u pasua nga një sërë takimesh të tjera kolektive dhe individuale pranë shtëpive të tyre dhe në zyrën e TLAS.

Veprimi i parë që duhet të bënin këto familje ishte dorëzimi në zyrën e Urbanistikës së Njësisë Bashkiake, të formularit të plotësuar "Kërkesë për t'u trajtuar me strehim". Këto formularë mund të tërhiqen pranë Njësiave Bashkiake dhe mbasi të plotësohen të gjitha rubrikat, ky formular duhet të noterizohet. TLAS u kujdes për sigurimin e formularëve, plotësimin dhe noterizimin e tyre. Dorëzimi i formularëve pranë njësiave bashkiake bën të mundur fillimin e shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Bashkisë së Tiranës.

Më poshtë po përshkruajmë dokumentatetjerëqëduhettëdorëzohen pranë Bashkisë së Tiranës, për të përfituar bonusin e qirasë.



1. Çertifikatë personale e kryefamiljarit me fotografi;
2. Çertifikatë familjare;
3. Çertifikatë e përbërjes familjare të vitit 1992;
4. Vërtetim banimi nga Njësia Bashkiake ku kërkohet strehim;
5. Vërtetim të statusit të jetimit, nëse dikush e gëzon këtë status;
6. Vërtetim të të ardhurave neto të familjes (vërtetim të pagave për ata që janë në marrëdhënie pune, të masës së ndihmës ekonomike nga Njësia Bashkiake, të pensionit nga Sigurimet Shoqërore, të pagesës së papu-

nësisë nga Zyra e Punës, të pagës së invaliditetit, për të gjithë anëtarët madhorë të familjes);

7. Vërtetim nga Zyra e Punës për të të gjithë anëtarët madhorë të familjes që janë regjistruar si të papunë;

8. Vendim nga Komisioni Mjekësor për personat me aftësi të kufizuar;

9. Dokumentacion nga organet tatimore dhe Sigurimet Shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët madhorë të familjes të vetëpunësuar;

10. Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave, nëse është ose jo sub-

jekt i taksës së vlerës së shtuar, për të gjithë anëtarët madhorë të familjes;

11. Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme për sipërfaqen e pronës, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e lejuara të strehimit;

12. Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme dhe Këshilli i Qarkut të vendit të origjinës (nëse nuk ka qënë në Tiranë në vitin 1992) se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, që mund të përdoret për strehim, për të gjithë anëtarët madhorë të familjes;

13. Vërtetim nga Kadastra (pranë Këshillit të Qarkut Tiranë), nëse ka përfituar ose jo nga ligji Nr. 7501 "Për Tokën", për të gjithë anëtarët madhorë të familjes;

14. Vërtetim nga Zyra e Urbanistikës pranë Bashkisë së Tiranës, nëse ka blerë ose jo truall nga shteti për ndërtim banese, për të gjithë anëtarët madhorë të familjes;



15. Deklaratë personale e noterizuar e kryefamiljarit, ku përfshihen të gjitha pikat e mësipërme;

16. Kontratë qiraje e noterizuar e banesës ku jetoni.

TLAS u përkujdes për grumbullimin e gjithë dokumentacionit të sipërpërmendur për secilën prej familjeve që u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre, për shkak të planit rregullues të Tiranës, që parashikon ndërtimin e një rruge të re në atë zonë. Mbas dorëzimit të dokumentacionit pritet shqyrtimi i tij nga ana e Këshillit bashkiak, i cili do të vendosë nëse familja mund të përfitojë Bonusin e Qirasë, si edhe sa do të jetë ky bonus.

Elvira Dervishi
Këshilltare Programi
TLAS

Padia civile ne proçesin penal

Rëndësia e këtij mjete juridik qëndron në të drejtën që i garanton çdo personi të dëmtuar nga vepra penale të dëmshpërblehet për dëmin e pësuar. Personi i dëmtuar do të jetë viktimë e dëmeve materiale, gjithashtu morale e shëndetësore. Personi fajtor, jo vetëm, që penalizohet për veprën penale të kryer, por njëkohësisht është i detyruar të shpërblejë të dëmtuarin për dëmet e shkaktuara si rezultat i kësaj vepre. Vitet e fundit ka patur një rritje të veprave penale, sidomos të atyre kundër pasurisë, duke dalë





si domosdoshmëri edhe gjykimi i padisë civile në këto procese, ndonëse numri i çështjeve të gjykuara në lidhje me këtë padi ka qënë jo shumë i lartë.

Në këtë mënyrë gjykatat nuk do të investoheshin dy herë për të njëjtën çështje, dhe për më tepër i dëmtuari do të kursente kohën dhe paratë në qoftë se çështja do të ndiqej në rrugë civile dhe penale. Kur i dëmtuari nuk dëshiron të kërkojë dëmshpërblimin civil në procesin penal, fare mirë mund t'i drejtohet me padi civile gjykatës civile sipas rregullave të përgjithshme. Ligjvënësi i ka krijuar të dëmtuarit nga vepra penale të gjitha mundësitë juridike për të rivendosur të drejtat e shkelura

nga vepra penale në procesin penal, apo edhe në atë civil.

Instituti i padisë civile në procesin penal i garanton personit rivendosjen e shpejtë të së drejtës së pronësisë të cënuar nga vepra penale. Qëllimi është garantimi i paprekshmërisë së të drejtës së pronës nga vepra penale, duke penalizuar kështu aktet e kundërligjshme, të cilat cënojnë të mirat e personit, shoqërisë apo shtetit.

Dëmtuesi detyrohet të zhdëmtojë të dëmtuarin në kushtet që parashikon ligji. Personi i dëmtuar përveçse ka të drejtën të kërkojë procedimin e fajtorit, i njihet e drejta edhe të shpërblehet për dëmin material shëndetësor ose moral, që ai ka pësuar si rezultat i vetëm dhe i drejtpërdrejtë i veprës. Me ligjet në fuqi garantohet, jo vetëm pacënueshmëria e marrëdhënieve juridike, që rregullon marrëdhëniet e pronësisë, por i sigurohet personit mjeti procedural për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së pronësisë së shkelur.

Në legjislacionin penal dhe pikërisht në dispozitat e Kodit

të Proçedurës Penale dhe pikërisht nenet 58-68 kanë si qëllim dëmshpërblimin e të dëmtuarin nga vepra penale, me anë të padisë civile në procesin penal.

Në nenin 58 parag.1 të KPRP, ku thuhet "Personi i dëmtuar nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë proçedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit". Proçesi penal mund të ketë si objekt aksesor një kërkesë për shpërblim dëmi, që ngrihet nga i dëmtuari kundër të pandehurit ose personave të tjerë, që përgjigjen civilisht për veprimet e të pandehurit për riparimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Padia civile në proçesin penal do të dallohet nga një padi civile nga fakti se kjo do t'i nënshtrohej ekskluzivisht dispozitave të Kodit Civil dhe Kodit të Proçedurës Civile dhe nuk do t'i nënshtrohej aspak proçedurës penale. Padia civile është një padi për shpërblimin e dëmit, jo si një padi për shpërblimin e dëmit me një origjinë çfarëdo, por të një dëmi që e ka burimin tek shkelja e ligjit penal.



Ky gjykim i njëkohshëm do të paraqiste mjaft avantazhe:

- *Gjykimi i padisë civile në procesin penal ndalon dhënien e vendimeve kontradktore për të njëjtin fakt nga gjykata të ndryshme .*
- *Efikasitetit i procesit gjyqësor.*
- *Ekonomizim i procesit gjyqësor.*
- *Lejon vendosjen e drejtësisë me shpejtësi më të madhe sesa gjykimi civil.*

Dëmi, objekt i padisë civile ka natyrë jashtëkontraktore dhe karakter material. Për këtë arsye, në gjykimin e padisë civile në proçesin penal zbatohen nenet 608 e në vijim të KC, që flasin për dety-

rimet të cilat rrjedhin nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor.

Qëllimi sipas legjislacionit tonë është, që personi fizik apo juridik të kthehet në gjëndjen e mëparshme, me të drejtat e tij reale mbi pasurinë. Ky objekt del qartë në nenin 61 të KPrP ku thuhet se: "padia civile ka si qëllim kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit".

Shpërblimi i dëmit përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. I dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e vlerave materiale të humbura efektivisht si dhe fitimet, që ai do të realizonte normalisht në qoftë se, nuk do të ndodhte vepra penale.



Dëmi duhet të jetë shëndetësor. Nga vepra penale i dëmtuari mund të pësojë edhe një dëm shëndetësor. Në nenin 641 të KC personi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, që i ka shkaktuar humbje ose pakësim të aftësive për punë si dhe shpenzimet mjekësore.

Dëmi mund të jetë moral. Vepra penale, mund të shoqërohet edhe me cënime të nderit dhe dinjitetit të të dëmtuarit. I dëmtuari mund të jetë i detyruar t'i nënshtrohet poshtërimit dhe fyerjeve personale.

Dëmi mund të jetë personal. Padia civile ngrihet nga ai që është dëmtuar personalisht d.m.th i prekur personalisht në integritetin e tij fizik, pasurinë dhe nderin e tij.

Kërkesa për shpërblim dëmi drejtuar gjykatës në procesin, nuk ndryshon për nga forma me padinë civile në procesin civil. Ajo duhet të përmbajë të gjitha elementet, që kërkon neni 154 i KPrP për kërkesë padinë drejtuar gjykatës civile.

Me qëllim që të garantohej ekzekutimi real i vendimit të

gjykatës për shpërblimin e dëmit, ligji detyron organin proçedues të marrë masa për sigurimin e padisë civile. Një ndër veprimet proçeduriale më të rëndësishëm të prokurorit, si një garanci për të drejtat e të dëmtuarit është vendosja e sekuestros konservative. Sekuestroja konservative vendoset mbi pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, gjithmonë kur ka “arsye të bazuara” për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dëmshpërblimit.

Paditësi civil fiton cilësinë e palës në proçes me gjithë pasojat juridike proçeduriale, por vetëm përsa i përket çështjes së dëmshpërblimit.

Dënimi penal i fajtorit nuk riparon dëmin material, moral apo shëndetësor, që i dëmtuari ka pësuar si rezultat i veprës penale, por sjell ndëshkimin e fajtorit dhe parandalimin e tij për të kryer në të ardhmen veprime të tjera kriminale. I dëmtuari rivendos interesat e cënuara nga vepra penale, duke ngritur padi civile para gjykatës

civile, veçse kjo do të kërkonte investim kohë dhe para, të cilat eliminohen me ngritjen e padisë civile në proçesin penal.

Anisa Haxhiaj
Avokate / keshilltare paraligjore
TLAS



DETYRIMI PËR USHQIM PËR FËMIJËT E LINDUR JASHTË MARTESE

Pranë Zyrës tonë rreth 1 vit më parë u paraqit një kliente me initiale K.N, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë. Nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar pension ushqimor për djalin e saj të mitur të lindur jashtë martese, pasi babai i fëmijës pavarësisht se e kishte njohur atësinë e fëmijës nuk pranonte të kontribuonte në mirërritjen e fëmijës.

Janë pikërisht këto raste të cilat po shtohen dita ditës në shoqërinë Shqiptare, pasi siç dihet është rritur mjaft numri i martesave të faktit (martesa jo në kuptimin ligjor, bashkëjetesës),



dhe janë pikërisht këto probleme që hasen pas ndërprerjes së bashkëjetesës. Pasi fëmija jeton me njërin nga prindërit dhe fakti se fëmija nuk jeton me prindin tjetër nuk e shkarkon atë nga detyrimi për të kontribuar për një jetesë më të mirë të fëmijës së tij.

U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm të cilat vërtetonin faktin që fëmija jetonte me nënën dhe të gjithë dokumentat që u konsideruan të nevojshëm për fillimin e procesit gjyqësor.

U mendua që të hartohej një kërkesë padi duke u thirrur si i paditur në gjykim i ati i fëmijës.

Vetë termi bashkëjetesë është shume i perdorur këto vitet e fundit por sipas nenit 163 të Kodit të Familjes :“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”.

Për fëmijët e lindur jashtë martese neni 170 i Kodit të Familjes parashikon: “Amësia dhe atësia e fëmijës se lindur jashtë martese mund të vendo-

sen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon të drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesë". Pra nga neni i mesipër kuptohet qartë se edhe fëmijët që janë fryt i bashkëjetesës gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur nga martesë dhe prindërit e tyre kanë të njëjtat detyrime njësoj si për fëmijët e lindur nga martesë.

Sipas nenit 192 pika "b" e Kodit të Familjes "Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijës së tyre", pavarësisht nëse fëmija ka lindur jashtë martesë apo nga martesë, madje nei 196 përmend faktin se edhe në qoftë se njërit nga prindërit i është hequr përgjegjësia prindërore, përsëri ai nuk mund ti shmanget detyrimit për ushqim ndaj fëmijës së tij. Neni 197 prashikon "Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka



pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhore ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç". Pra duke iu rikthyer rastit të klientes K.N, duke marrë parasysh moshën e mitur të djalit të saj dhe vështirësinë financiare në të cilën ajo ndodhej, ajo në bazë të të gjithë neneve të përmendur më lart përligjej plotësisht në kërkimin e saj, duke kërkuar një jetë më të mirë për fëmijën e saj. U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore dhe gjykata arriti në përfundimin se klientja K.N kishte



të drejtë në kërkimin e saj duke i lidhur në këtë mënyrë një pension fëmijës së klintes K.N. Në këtë mënyrë ky fëmijë do të ketë një të ardhme më të mirë dhe do të ketë mundësi më të mëdha për të pasur një jetesë normale njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë. Mbas një pune pothuajse 2 vjeçare duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klientja K.N.

Adrian Shega
Avokat / Keshilltar paraligjor
TLAS

Histori e vërtetë

G.Gj. ka tre fëmijë të paregjistruar në gjëndjen civile, të moshave 8, 7 dhe 3 vjeç. Të tre fëmijët kanë lindur në maternitet, në Tiranë. Këta fëmijë nuk janë regjistruar për shkak se nëna e tyre në maternitet është regjistruar me një emër tjetër (P.Gj.), me emrin me të cilin e thërrasin në shtëpi dhe jo me emrin me të cilin ajo është regjistruar në regjistrat e gjëndjes civile.

Në çertifikatat e lindjes së fëmijëve të lëshuara nga materniteti G.Gj. figuron si P.Gj. Nga ana tjetër G.Gj. nuk është paraqitur për të regjistruar fëmijët e saj në zyrën e gjëndjes civile ku ajo ka patur regjistrimin, brenda afatit ligjor. Familja e G.Gj. është shpërngulur në një komunë të rrethit të Tiranës, që prej 10 vjetësh dhe kur lindën tre fëmijët e saj, nuk e kishin bërë ende transferimin e dokumentave të gjëndjes civile në vendin ku ata jetonin. Për këtë arsye lindjet e fëmijëve duhet të regjistroheshin në komunën e origjinës, atje ku

familja figuronte ende e regjistruar në gjëndjen civile. G.Gj. duhet të shkonte atje për të regjistruar fëmijët. Ajo nuk e bëri këtë gjë, për shkak se komuna e origjinës është shumë larg nga vendbanimi i saj dhe familja e G.Gj. jeton në kushte shumë të vështira familjare. Nëse dikush nga familja do të ishte paraqitur në këtë zyrë për të regjistruar fëmijën e parë, do ishte konstatuar që ajo kishte dhënë emrin e saj jozyrtar dhe ky gabim nuk do të ishte përsëritur të paktën për dy fëmijët e tjerë.

Para dy vjetësh familja e G.Gj. bëri transferimin e dokumentave të gjëndjes civile në komunën e rrethit të Tiranës, ku tashmë banon dhe G.Gj. u paraqit në këtë zyrë për të bërë regjistrimin e tre fëmijëve. Por fëmijët nuk u regjistruan, sepse raportimi ishte mbas afatit ligjor prej 45 ditësh mbas lindjes së tyre. Sipas ligjit, vërtetimi i lindjes së tyre mund të bëhej vetëm me anë të gjykatës. Kur TLAS morri përsipër të realizonte regjistrimin nëpërmjet gjykatës, u vu re se emri i

raportuar në maternitet ishte i ndryshëm nga emri i vërtetë i nënës. Kjo gjë krijoi një problem shumë të madh, sepse dilte detyra e vërtetimit të faktit që G.Gj. dhe P.Gj. ishte i njëjti person.

Vështirësia më e madhe qëndronte edhe në faktin se G.Gj. dhe bashkëshorti i saj nuk mund t'i ndiqnin vetë problemet e shumta të vërtetimit të ndryshimit të emrit, si për shkak të gjëndjes së vështirë ekonomike, ashtu edhe për shkak të nivelit të tyre arsimor. Për këtë arsye, TLAS është angazhuar dhe po vazhdon procedurat për grumbullimin e provave për të vërtetuar se G.Gj. dhe P.Gj. janë i njëjti person. Për këtë arsye janë



marrë vërtetime nga kryeplaku i fshatit ku ajo banon, nga kryeplaku i fshatit ku ajo ka banuar më përpara, se në shoqëri G.Gj. njihet me emrin P.Gj. Po kështu, është marrë vërtetim nga shkolla 8 vjeçare e vendit të origjinës, se ajo ka ndjekur këtë shkollë me emrin P.Gj. Në dokumentin e shkollës vërehet se P.Gj. ka të njëjtë me G.Gj. datëlindjen, vendlindjen dhe emrin e babait. Për të grumbulluar të gjitha këto prova na është dashur të lidhemi me shumë zyra të pushtetit vendor dhe atij qendror. Puna për grumbullimin e plotë të provave nuk ka mbaruar, ndërkohë që të tre fëmijët vazhdojnë të jenë të paregjistruar.



Kjo gjëndje e vështirë është arritur për shkak të disa gabimeve që janë bërë:

1. Materniteti duhet të kërkonte brenda kohës së shtrimit të nënës çertifikatën e saj personale me fotografi, apo të paktën çertifikatën familjare të saj. Neglizhenca e tyre në këtë drejtim solli edhe këtë problem të madh për regjistrimin e fëmijëve.
2. Nëna duhet të jepte në maternitet emrin e saj zyrtar.
3. G.Gj. dhe bashkëshorti i saj duhet të raportonin lindjen e fëmijëve në zyrën e gjëndjes civile brenda afatit ligjor prej 45 ditësh.
4. Familja e G.Gj. duhet të bënte transferimin e dokumentave të gjëndjes civile në vendbanimin e ri brenda afatit ligjor prej 45 ditësh.

Të gjitha këto gabime ndodhën jo vetëm për shkak të pamundësisë financiare të familjes për të udhëtuar deri në vendin e origjinës, por edhe për shkak të mosnjohjes së afateve lig-

jore të përcaktuara për regjistrimin e lindjeve dhe transferimit. Organet e pushtetit vendor dhe ato të pushtetit qendror përgjegjëse, nuk kanë bërë sa duhet për ndërgjegjësimin e njerëzve për këto afate ligjore.

Duke u nisur nga problemet e shumta të konstatuara, jo vetëm nga ky rast, por edhe nga shumë raste të tjera, TLAS ka ndërmarrë një nismë ligjore për disa ndryshime në procesin e regjistrimit të lindjeve dhe transferimeve. Kjo nismë ligjore është miratuar tashmë dhe pritet që të hyjë së shpejti në fuqi. Ligji i ri i ndryshuar, jo vetëm që nuk do të sjellë pengesa, nëpërmjet regjistrimit nëpërmjet gjykatës, por do të nxisë regjistrimin brenda një kohe prej 60 ditësh, nëpërmjet edhe dhënies së shpërblimeve për nënat e reja.

Elvira Dervishi
Këshilltare Programi
TLAS

Histori e vërtetë

M.Z. është një kliente, e cila Mi përket komunitetit rom. Pjesa më e madhe e anëtarëve të këtij komuniteti, për të arritur të nxjerrin të ardhura për të shtyrë jetesën e tyre dhe të familjeve të tyre, grumbullojnë mbeturina nëpër kazanet e plehrave apo nëpër grumbujt e mbeturinave në zonën e Sharrës. Kushtet e vështira ekonomike dhe situatat e ngatërruara familjare, i kanë bërë keta persona që një pjesë e madhe e tyre t'i drejtohen për ndihmë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë.

Klientja M.Z. u paraqit fillimisht pranë zyrave të TLAS, për





të përfituar ndihmë ligjore pasi ajo kërkonte ndarjen prej bashkëshortit të saj. Gjatë punës paraleligjore klientja kërkonte të ndahej ligjërisht prej bashkëshortit të saj, me të cilin kishte qenë e martuar prej 15 vjetësh, pasi marrëdhëniet e tyre në vitet e para të martesës kishin qenë të mira e më pas ato ishin përkeqësuar së tepërmi, pasi ai ushtronte dhunë ndaj saj. Pasi kishin qëndruar disa vite së bashku, ish bashkëshortit të saj i ishte hequr liria për shkak të kryerjes së një veprë penale dhe tani ai ndodhej në burg duke vuajtur një dënim prej disa vitesh. Klientja duke mos patur asnjë kontakt me të dhe të afërmit e tij, të cilët prej kohësh nuk jetonin në Tiranë, nuk

mund të thoshte se ku vuante dënimin ai. Intervista paraleligjore u ndërlikua pasi në një proces të tillë prania e palëve është e domosdoshme. Në këtë mënyrë duhej të ndërmerrej një hetim, për të gjetur vendin e dënimit të ish-bashkëshortit. Këshilltarja paraleligjore krijoi lidhje me komisaritet e policisë dhe autoritetet e Ministrisë së Brendshme për të kërkuar ndihmë. Autoritetet bënë verifikime me autoritetet e burgjeve në bazë të vendimit të Gjykatës që TLAS kishte siguruar më parë, për të verifikuar llojin e dënimit, që Gjykata kishte vendosur për të dhe në këtë mënyrë do të ndihmoheshin autoritetet me informacionin e nevojshëm, se ku vuante dënimin personi.

Gjatë gjykimit të zgjidhjes së martesës gjyqtarja kërkoi në bazë të Kodit të Familjes, praninë e bashkëshortit të dënuar. Autoritetet e policisë dhe të burgut mundësuan praninë e tij dhe gjykimi vazhdoi në përputhje me ligjin dhe brenda afateve të përcaktuar në të. TLAS më pas mundësoi regjistrimin e vendimit të gjykatës në

regjistrat e gjendjes civile, ku duhej të shënohej zgjidhja e martesës. Nëpunësja e gjendjes civile informon se klientja M.Z. kishte një fëmijë disa muajsh ende të paregjistruar ne regjistrat e gjendjes civile, të cilit i kishte kaluar afati i deklarimit të lindjes së tij prej muajsh dhe lindte në këtë mënyrë problemi i bërjes së konfirmimit të faktit të lindjes së fëmijës nëpërmjet procedurës së gjykatës.

Klientja deklaroi se avokati i TLAS se fëmija kishte lindur gjatë një lidhje tjetër të saj me një person tjetër, me të cilin bashkëjeton prej disa vitesh. Ajo nuk e kishte regjistruar fëmijën pasi mendonte se ish-bashkëshorti i saj do të ngrinte pretendime ndaj fëmijës dhe ndaj saj. Fëmija gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të gjyimeve, që prej lindjes ka qenë në kushte të këqija shëndetësore dhe nuk mund të përfitonte asnjë mjekim prej mjekëve për shkak të mungesës së çertifikatës së lindjes së gjendjes civile. Klientja nuk mund ta regjistronte fëmijën as në kopësht dhe



detyrohej ta mernte me vete gjatë grumbullimit të plehrave.

Avokati i TLAS ndërmori procedurën e konfirmimit të faktit të lindjes së fëmijës së klientes në Gjykatë dhe ky fëmijë tashmë është i regjistruar në regjistrat e Zyrës së gjendjes civile dhe mund të tërheqë lehtësisht një çertifikatë personale. Ndërkohë puna e avokatit të TLAS vazhdon në përcaktimin e atësisë së fëmijës, pasi fëmijët e lindur gjatë martesës së prindërve prezumohet se kanë për baba bashkëshortin e nënës. Klientja M.Z. nuk bashkëjetonte prej kohësh me bashkëshortin e parë, por me një person tjetër, i cili është i ati i fëmijës, por që Kodi i Familjes nuk e njeh si të



tillë, pasi fëmija është lindur ende pa zgjidhur martesën e parë.

Gjykata ia njohu atësinë e fëmijës personit me të cilin bashkëjeton klientja dhe ndërkohë ata lidhën martesën ligjore.

Anisa Haxhiaj
Avokate / Këshilltare paraligjore
TLAS

Histori e vërtetë

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Terre des Hommes në projektin “Për zbatimin e veprimeve ndërkom-bëtare kundër trafikimit të fëmijëve (TAKT), “TLAS” është duke trajtuar një çështje për regjistrimin e fëmijëve. Rasti i përket klientes M.M.

Klientja M.M banon në Nishtullë, qarku Durrës dhe është nënë e 7 fëmijëve, dy prej të cilëve janë pa regjistruar. Fëmijët e saj të paregjistruar M. dhe R. janë përkatësisht 10 dhe 8 vjeç.

Ajo jeton në kushte shumë të vështira ekonomike, në një barake me lecka dhe kartona ku një stol i vjetër shërben si krevat për një pjesë të fëmijëve, ndërkohë që të tjerët shtriheshin në tokë.

Kontakti ynë i parë me ta ishte tronditës. Fëmijët që po loznin rreth barakës na rrethuan duke na pyetur me shumë kuriozitetet pse kishim ardhur. Këmbazbathur në mes të pellgjeve me ujë nuk na i kursyen buzëqeshjet dhe ftesat dashamirëse për

të lozur me ta. Veshur hollë dhe me rroba të vjetra e të grisura ata sfidonin motin e ftohtë të atyre ditëve dhe shpreheshin se ishin “të kënaqur që ja kishin hedhur edhe për sot”.

Megjithatë, problemet ekonomike nuk ishin të vetmet që shoqëronin këtë rast.

Çështja e tyre ligjore nuk ishte një regjistrim klasik, duke qenë se M.M jo vetëm që kishte pa regjistruar dy fëmijë, por të dy kishin lindur në kushte shtëpie (kishim pra të bënim me dy raste vërtetimesh fakti).

Pas vendosjes së kontakteve me M.M filluam punën për grumbullimin e materialeve të nevojshme për procedurën e regjistrimit të fëmijeve në Gjykatën e Rrethit Durrës.

Vështirësia e parë u ndesh në marrjen e certifikatave në Zyrën e Gjendjes Civile. Klientja nuk kishte asnjë dokument identifikues, si rrjedhojë punonjësit atje refuzonin t’i lëshonin një certifikatë personale, pasi nuk ishin të bindur për identitetin e saj. Ne provuam të shoqëronim M.M në zyrën e gjendjes civile duke



i sqaruar atyre punën që ne bënim dhe arsyen pse kërkonim tërheqjen e këtyre dokumenteve. Punonjësit e Gjendjes Civile fillimisht nuk arrinin të gjenin klienten në regjistrat e tyre dhe ngrinin pretendimin se ajo ose nuk kishte tërhequr kurrë certifikatë, ose nuk ishte banore e asaj njësie. Nga ana tjetër klientja pohonte që kishte tërhequr edhe më parë certifikatë, por nuk mbante mend numrin e regjistrit, apo një të dhënë tjetër që mund të lehtësonte punën e tyre. Deklarata e një punonjësi që vërtetonte se M.M ishte banore e asaj njësie si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të këshilltarit të TLAS tek punonjësit e zyrës së Gjendjes Civile bënë të mundur

sigurimin e çertifikatës personale të M.M, çertifikatës së martesës dhe asaj familjare.

Meqë të dy fëmijët kishin lindur në kushte shtëpie dhe pa asistencën mjekësore, duheshin siguruar dokumente të tjera për të provuar moshën apo lidhjen e fëmijëve me nënën. Së pari kontaktuam me dëshmitarët, përkatësisht nënën, motrën si dhe banorë të lagjes që kishin asistuar në lindjen e fëmijëve, nga të cilat u mor konfirmimi se ishin të gatshme të jepnin dëshminë e tyre.

Klientja M.M ishte shumë e vështirë të kontaktohej. Për shkak të mungesës së një telefoni personal - lidhjet bëheshin nëpërmjet telefonit të komshiut dhe duke qënë se M.M e kalonte kohën duke lypur bashkë me fëmijët, shumë herë asistentët e TLAS janë detyruar të kthehen në Tiranë pa mundur të bëjnë asgjë.

Për më tepër M.M filloi të pretendonte se njërin prej fëmijëve mund ta kishte lindur edhe në maternitet, por nuk ishte e sigurtë nëse e kishte lindur

në maternitetin e Durrësit apo të Shkodrës. Pasi kontaktuam me maternitetin e Durrësit dhe Shkodrës, dhe pas kontrolleve që u bënë në regjistrat përkatës të lindjes, rezultoi se asnjë nga këta dy fëmijë të M.M nuk kishin lindur në maternitet. Kështu që çdo dyshim i klientes u hodh poshtë dhe përfundimisht kishim të bënim me dy raste lindjeje në kushte shtëpie, pa asistencë mjekësore.

Probleme shoqëruan edhe mbledhjen e dokumenteve të tjera, një prej të cilave ishte deklarata me ndërlidhësin e komunitetit. Ndërlidhësi me komunitetin, në kohën kur po mbledheshin dokumentet e nevojshëm, ishte



zëvendësuar dhe personi i sapo emëruar refuzoi të jepte një deklaratë për M.M, pasi - siç u shpreh edhe vetë - ai nuk i njihë ende banorët e zonës, dhe nuk mund të jepte asnjë të dhënë për ta.

Asistentë e TLAS janë duke gjetur mënyra të tjera për të siguruar dokumentet e nevojshme për në gjykatë. Tashmë është kontaktuar përfaqësuesi i shoqatës rome në Durrës “Amarodrom”, i cili banon në të njëjtën lagje me klienten M.M dhe që ka shprehur vullnetin të deklarojë se e njeh atë si nënën e dy fëmijëve, R. dhe M.

Ndërkohë që presim që ndërli-dhësi i komunitetit të “njihej” me

banorët, po vendosim kontaktet me mjekun peditër.

Pas gjithë këtyre vështirësive, jemi në fund të rrugës dhe mbylljes me sukses të çështjes së regjistrimit të dy fëmijëve të klientes M.M.

Fjoralba Caka
TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 / 2008

TLAS

